

Data 19.07.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II: Ndërtim Ura në Tushemisht, Ura në Fshatin Zahrisht, Ura e Cenit, Ura në fshatin Bellovë, Ura në Fshatin Lenie, Ura në fshatin Metoq dhe Ura në rrugën Tamarë-Vukël.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

VLERA E FONDIT LIMIT: 208.243.122,65 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor për periudhën 2024-2026, Infrastruktura vendore rajonale (IVR)_Kodi i Projektit **23AA101**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkoet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i)*

totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet

Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat/teknologjinë dhe/ose karakteristikat të tjera të përshkruara në raportin teknik.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

i) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

ii) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një

standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

N.P -	1.	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P -	4.	C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
N.P -	5.	C	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

N.S -	1.	A	Punime për prishjen e ndërtimeve.
N.S -	6.	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
N.S -	7.	A	Barriera dhe mbrojtje rrugore.
N.S -	8.	B	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
N.S-	18	A	Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P-1. A	Punime gjurmimi në tokë	<ul style="list-style-type: none"> Germim dheu me ekskavator zingjir, toke e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km 	0-20 mln leke
N.P- 4 C	Rrugë, autostrad, mbikalime, hekurudh, tramvai, metro, pista aeroportuale.	<ul style="list-style-type: none"> Shtresë asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri F. V. fugë zgjerimi elastomerike e armuar me zhvendosje totale 70mm 	0-20 mln leke
N.P-5 C	Punime nëntokësor, ura e vepra arti	<ul style="list-style-type: none"> Shtrese zhavor lumi t=20cm Mbushje me çakëll pas balleve Struktura monolite betoni me çakëll C30/37 (ballet, stolat, pykat antisiz, soleta rakorduese) Struktura monolite betoni me çakëll C30/37 për mbistrukturën (soleta dhe diafragmat) Shpim me sonda Ø1000mm, me kemishim gjatë procesit të shpimit. Struktura monolite betoni me çakëll C 25/30 (pilotat) F.V. Kushineta 600x500x160 mm F.V. Aparat elastomerik Tipi F 500x300x40 mm F.V. Aparat elastomerik Tipi F 300x200x40 mm F.V. Kushineta 320x420x83 mm F.V. Aparat elastomerik Tipi F 200x400x30 mm 	51-100 mln leke
N.S-1. A	Punime për prishjen e ndertimeve	<ul style="list-style-type: none"> Prishje e strukturave prej betoni 	0-20 mln leke
N.S-6. A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	<ul style="list-style-type: none"> F.V. Sinjale për rrugë urbane dhe interurbane kryesore Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30 Tabelë rrethi "ndalim" normal me D = 60 Tabelë trekendore normal me A = 90 Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Termoplastike (sprajt) Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm. Termoplastike (paste) 	0-20 mln leke
N.S-7. A	Barriera dhe mbrojtje rrugore	<ul style="list-style-type: none"> Guardrail H2 anesore për ure me 3 valez. në 1 ane+handrail, W4 + aksesoret Guardrail H2 anesore për ure me 2 vale në 1 ane+handrail, W5 + aksesoret 	21-50 mln leke
N.S-8. B	Ndërtime parafabrikat	<ul style="list-style-type: none"> F. V. Trarë "T" C45/55 me L=29.3 m, të parapërgatitur dhe të pas-nderur (me tërheqje të kavove pas betonimit), përfshin, kallëpet, 	21-50 mln leke

	beton arme, struktura metalike dhe druri	kavot e paranderjes dhe aksesorët, tërheqjen, Ilaçin special dhe montimin. - F. V. Trarë "T" C45/55 me L=25.3 m, të parapërgatitur dhe të pasnderur (me tërheqje të kavove pas betonimit), përfshin, kallëpet, kavot e paranderjes dhe aksesorët, tërheqjen, Ilaçin special dhe montimin. - F. V. Trarë "T" C45/55 me L=23.2 m, të parapërgatitur dhe të pasnderur (me tërheqje të kavove pas betonimit), përfshin, kallëpet, kavot e paranderjes dhe aksesorët, tërheqjen, Ilaçin special dhe montimin.	
N.S-18. A	Punime topogjeodezi ke.	- Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik	0-20 mln leke

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë në stafin drejtues të punësuar dhe regjistruar, si më poshtë:

3 (tre) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Ndërtimi me profilin Transport

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

2 (dy) Inxhinier Gjeodet

1 (një) inxhinier Mjedisi

Staf Mbështetës

Menaxher Projekti/Inxhinier Strukturist

Inxhinier Strukturist

Inxhinier Hidroteknik

Inxhinier Transporti

Kat. 5.d: Projektues Vepra Hidroteknike - Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.

Kat. 7.bProjektim Ura dhe Vepra Arti - Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.

Kat. 7.cProjektim Ura dhe Vepra Arti - Projektim Ura/viadukte me hapësira të mëdha drite, ura të varura , ura me sisteme të pacaktuara statikisht dhe sisteme të tjera speciale.

Kat. 11.a Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Stafi i sipërcituar është staf mbështetës për përgatitjen e projektit të zbatimit (Faza III-VI), duhet te plotesojnë kushtin e kategorive respektive te licensave dhe eksperiencën cituar me sipër.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV

- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e **personelit kryesor** në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektiv në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

Inxhinier Ndërtimi	Inxhinieri i ndërtimit nevojitet per organizimin e kantierit te ndërtimit, për ndjekjen në tërësi të punimeve dhe bën koordinimin e të gjithë personelit teknik në objekt për mbarëvajtjen e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe grafikut të parashikuar në kontratë. (Referuar zërave të punimeve të preventivit)
Inxhinier Ndërtimi me profilin Transport	Inxhinieri me profilin Infrastruktura Transporti nevojitet për kontrollin e piketimit në përputhje me projektin e zbatimit, gjeometrinë e rrugës, parametrat teknike te saj. (Referuar zërave te punimeve të preventivit).
Inxhinier Hidroteknik	Inxhinieri hidroteknik nevojitet për ndjekjen e punimeve të kullimit të ujërave dhe punimeve të mbrojtjes lumore; (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Gjeodet	Inxhinieri gjeodet nevojitet për piketimin fillestar të objektit dhe piketimin në vazhdimësi të të gjithë punimeve sipas proceseve të punës. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mjedisi	Inxhinieri i mjedisit nevojitet per ndjekjen e punimeve të gërmimit për ndërtimin e urave me qëllim ruajtjen e gjelbërimit (bimësisë se ulet dhe te pyllit) ne dy anët e urave, ruajtjen e ambjentit gjate kryerjes se punimeve; përcaktimin/selektimin e pikës se depozitimit se hedhurinave dhe materialeve te dala nga gërmimi. (Referuar zërave te punimeve te preventivit).

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet te jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohet te jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **60** persona për periudhën, tremujoje nga data e zhvillimit te procdures e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen tre mujor e nga data e zhvillimit të tenderit,
- Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregojnë besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 60 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, I ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Nga llogaritja e orëve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të çmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si mëposhte:

Total orë pune = 216'000 orë (sipas grafikut të punimeve)

Ore/1 ditë pune = 8 ore

Total Ditë pune puntori = 216'000 orë/8 orë = 27'000 ditë pune

Dite pune gjithsej = 18 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 25 ditë/muaj = 450 ditë pune

Numri i fuqisë punëtore = 27'000 dite pune /450 ditë = 60 puntorë

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohet për realizimin e punimeve është min **60 puntorë**

Ne menyre te permbledhur numri I fuqise puntore qe kerkohet per realizimin e punimeve eshe min **60 puntore**

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi/qira/kontrate furnizimi).

Nr.	Mjeti	Sasia (copë)	Statusi
1.	Kamion me kapacitet mbajtës deri minimumi 20 ton	6	Pronësi ose qira
2.	Ekskavator me zinxhir minimumi 0.5 m ³	3	Pronësi ose qira
3.	Ekskavator me goma minimumi 0.25 m ³	3	Pronësi ose qira
4.	Fadromë me goma	3	Pronësi ose qira
5.	Sondë për pilota, thellësi minimumi 20 m dhe diametër 0.8 -1.2 m	1	Pronësi ose qira
6.	Auto vinç minimumi 150 ton	1	Pronësi ose qira
7.	Rul ngjeshës minimumi 5 ton	3	Pronësi ose qira
8.	Kompaktor ngjeshës minimumi 100 kg	3	Pronësi ose qira
9.	Auto-pompë betoni	3	Pronësi, qira ose kontratë me subjekte që prodhojnë beton.
10.	Autobetoniere	3	Pronësi, qira ose kontratë me subjekte që prodhojnë beton.
11.	Betoniere kantieri	3	Pronësi ose qira
12.	Kompresor	1	Pronësi ose qira
13.	Gjenerator	1	Pronësi ose qira

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- d) Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

Argumentimi: Numri i makinerive është përcaktuar në baze të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për secilën proces pune është përcaktuar lloji i makinerive dhe ditët e punës përkatëse. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

ARGUMENTIMI MJETET

Mjetet	Sasia (copë)	Proceset e punës
Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	6	- Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km
Ekskavator me zinxhir minimumi 0.5 m ³	3	- Germim dheu me ekskavator zingjir, toke e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet - Prishje e strukturave prej betoni
Ekskavator me goma minimumi 0.25 m ³	3	- Germim dheu me ekskavator zingjir, toke e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet - Sistemim skarpatash
Fadromë me goma	3	- Shtrese zhavorri - Mbushje me çakëll pas balleve
Sondë për pilota, thellësi minimumi 20 m dhe diametër 0.8 -1.2 m	1	- Shpim me sonda Ø1000mm, me kemishim gjatë procesit të shpimit.
Auto vinç minimumi 150 ton	1	- Montim trarësh të parafabrikuar
Rul ngjeshës minimumi 5 ton	3	- Ngjeshje e mbushjeve pas balleve
Kompaktor ngjeshës minimumi 100 kg	3	- Ngjeshje e shtresave në zona të ngushta pas balleve dhe mure
Auto-Pompe betoni	3	- Betonim të urave integrale, themeleve, ballnave soletave, diafragmave dhe soletave rakorduese.

Autobetoniere	3	- Betonim të urave integrale, themeleve, ballnave soletave, diafragmave dhe soletave rakorduese.
Betoniere kantieri	3	- Betonime në sasi të vogla.
Kompresor	1	- Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik
Gjenerator	1	- Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. -Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe. Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerrat e punimeve jane pjese e pandare e DST.
Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët	75
2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike	pikët	5
3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët	5
4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)	pikët	10
5. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)	pikët	5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 75] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike

[0 –5 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këto kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshte:

Punime specifike për:

- Punime për ndërtimin e urave beton arme (një ose më shumë) me gjatësi totale jo më pak se 192.8 m për kontrata të kryera brenda një periudhë një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit 5 pikë

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 1 vjeçar, afat i cili nënkupton një periudhë 12 mujore të pandërprerë gjatë 5 viteve kalendarike. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punime dhe volume te kryera te realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për tu vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} / V_{\max k2} \times P_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik si dhe dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–5 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} / V_{\max k3} \times P_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k3} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} / V_{\max k4} \times P_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohe nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)

(jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur ne mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, perfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara).

Për shkak të rëndesisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet ne Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike ne masen jo me pak se 3%, përlogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas përcaktimeve te VKM nr. 216 date 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur ne vlerë, në këtë rast jo më pak se **5,573,892.03** leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë

formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Permbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zbatimin e Sigurisë në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera. 5,573,892.03 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera. 5,573,892.03 leke pa tvsh do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 5,573,892.03 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilësia në punime: siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shumë se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilësia në punimet e kryera: siguria në kantier/shendeti impakti në mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)

Mo – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

PR (Rrm) – Rritje e mundshme

$$Mo = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 200 \% Mo$$

Vlera e ofertave të ofruara > PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilësia në punimet e kryera: siguria në kantier/shendeti impakti në mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK ($200\% MO = 51,500,000 \text{ leke} < 55,000,000 \text{ leke}$) dhe vleresohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlere korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.